



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRRIË

DATË/A	09.12.2024
PËRMES/PREKO/THROUGH	Kryetarit të Komunës z. Ferit Idrizi 
NGA/OD/FROM:	Drejtori i DBZHR-së z. Ergin Sungur 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	THIRRJE PËR APLIKIM

Për fermerët e Komunës së Vushtrrisë për përfitim në kuadër të implementimit të projektit: "Subvencionimi i mbarshuesve të deleve dhe dhive"

I. Qëllimi i thirrjes për aplikim

Qëllimi i thirrjes për aplikim është njoftimi i të gjithë fermerëve mbarshues të deleve dhe dhive të Komunës së Vushtrrisë se Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në kuadër të Programit për Zhvillimin e Bujqësisë 2024 do të subvencionojë fermerët që mbarshtojnë dele dhe dhi në shumën prej 5 €/ krerë.

II. Kriteret e përcaktuara

- Aplikuesi duhet të jetë banorë i Komunës së Vushtrrisë;
- Aplikues për pagesa direkte 2024;
- Të mbarshtrojë;
 - Tridhjetë (30) e më shumë krerë dele;

- Njëzet (20) e më shumë krerë dhi

III. Dokumentacioni i nevojshëm:

1. Kopja e letërnjoftimit;
2. Konfirmimi i bankës për posedim të Llogarisë bankare;
3. Kopja e listës së verifikimit të kafshëve të lëshuar nga sektori për identifikim dhe regjistrin në kuadër të AUV për vitin 2024;
4. Vendimin për numrin e deleve dhe dhive të aprovuar për pagesë nga ana e AZHB-së për vitin 2024;

Kjo thirrje publike është e hapur për aplikim prej datës: **11.12.2024. – 27.12. 2024.**

Aplikacioni dorëzohet në zyrën e pranimit çdo ditë pune.